

VENDIM
Nr.25, datë 24.5.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.05.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Xhezair Zaganjori.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 dhe 179/1 të Kushtetutës, si dhe nenet 8/2 dhe 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr.3557, datë 14.11.2002 në mbështetje të nenit 125, pika 1 të Kushtetutës, ka emëruar zotit Xhezair Zaganjori, anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.65, datë 24.12.2002, në mbështetje të neneve 78 dhe 125 pika 4 të Kushtetutës, si dhe nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, ka dhënë pëlqimin për emërimin e zotit Xhezair Zaganjori në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Nga të dhënat rezulton se zoti Xhezair Zaganjori ka vijuar plotësimin e mandatit 9-vjeçar të gjyqtares Tefta Zaka, të papërfunduar prej saj, për shkak të dorëheqjes. Zonja Tefta Zaka betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 21.5.2001. Për rrjedhojë bazuar në nenin 8/3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, data 21.05.2010 konsiderohet edhe si datë e mbarimit të mandatit të vijuar prej zotit Xhezair Zaganjori si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Xhezair Zaganjori, në datën 21.05.2010.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Sadushi,
Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi